

**STATUTI I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“DELVINA SOLAR” SHPK**

**KREU 1**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**NENI 1**

Sot, më datë 19/12/2022, në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë, Ortaku i vetëm themelues:

- Shoqëria “AKSENT L&BC” Shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L91406014L, me seli në adresën: Njesia Administrative Nr.5, Bulevardi "Bajram Curri", Ndertesa 128, Hyrja 26, Kati 2, Ap.9, Tiranë, Perfaqsuar me autorizim te Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nga z.Edi Janina.

si themelues të kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**KREU II**  
**EMRI, FORMA, SELIA, KOHËZGJATJA**

**NENI 2**

**EMRI DHE EMËRTIMI TREGTAR**

- 2.1 Emri i shoqërisë është **“DELVINA SOLAR”shpk.**  
2.2 Emërtimi tregtar i shoqërisë është **“DELVINA SOLAR”**.

**NENI 3**  
**FORMA**

- 3.1 Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara për kapitalin.

**NENI 4**  
**SELIA**

- 4.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Njesia Administrative Nr.5, Bulevardi "Bajram Curri", Ndertesa 128, Hyrja 26, Kati 2, Ap.9, Tiranë.  
4.2 Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.  
4.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Me vendim të Administratorit mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 5**  
**KOHËZGJATJA**

S 1

5.1 Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

### **KREU III NENI 6 OBJEKTI**

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

6.2 Projektimin, ndertimin, instalimin, komisionimin, financimin, operimin, permiresimin, dhe mirembajtjen e centraleve te prodhimit te energjise nga dielli dhe infrastrukturet sherbyese, perfshire panelet fotovoltaikë si dhe linjat e transmetimit te energjise elektrike qe do lidhe centralet me rrjetin shqiptar te energjise; te prodhoje e shese energji elektrike te prodhuar nga centralet; te zoteroje te drejta kalimi qe do ta lejojne te lidhi centralet me rrjetin shqipetar te energjise elektrike me ane te linjes se transmetimit. Pervec sa me siper, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperm. Per arritjen e qellimit te mesiperm, Shoqeria mund te kryeje cdo transaksion lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajteshme, dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qeraje ose hipoteke, qe mund te konsiderohet i vlefshem ose i nevojshem ne menyre qe te ushtrohet objekti i Shoqerise.

### **NENI 7 KAPITALI**

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 (njëmijë) Lekë. Ortaku i vetëm Themelues ka kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë si më poshtë:

- Shoqëria “**Akesnt L&BC**” shpk kontribuon në kapitalin themeltar të shoqërisë me 1000 (njëmijë) Lekë.

7.2 Kapitali Themeltar i shoqërisë “**DELVINA SOLAR**” shpk përbëhet nga 1 (një) kuotë, e zotëruar nga ortaku i vetëm:

- Shoqëria “**AKSENT L&BC**” Shpk, zotërues i 1(një) kuote me vlerë 1000 (një mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

7.3 Kapitali i shoqerisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjeherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

### **NENI 8 MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

8.2 Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi t'ua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte të njëjta nga ato që do t'ju ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit, në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gjëzojnë këtë të drejtë.

8.3 Personi që kalon kuotën dhe ai qe e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të nenit 74 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

#### KREU IV

### ORGANET E SHOQËRISË NENI 9

9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Administratori.

9.2 Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

### NENI 10 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME KOMPETENCAT

10.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çeshtjeve të mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

### NENI 11 MBLEDHJA E ASAMBLESË

11.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mblidhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose ortakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

### NENI 12 THIRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE

12.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes

dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

12.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

12.3 Në rastin e marijes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

12.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

12.5 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesmarrës. Për emërimin e administratorit Asambleja vendos sipas pikës 14.1 të nenit 14 të këtij statuti.

12.6 Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal, i cili përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

12.7 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëpërmjet komunikimeve me shkrim, faks, postë elektronike dhe shërbime postare. Një vendim i Asamblesë së Përgjithshme mund të merret përmes qarkullimit të dokumenteve të shkruar, dhe si pasojë pra pa nevojen e mbajtjes së një mbledhjeje.

12.8 Ortakët që nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, marrin pjesë dhe votojnë me komunikim të ndërsjelltë (tele-konferencë) në përputhje me nenin 88 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

## **NENI 13** **ORGANI ADMINISTRATIV**

13.1 Administrator i parë i shoqërisë është:

- Znj. Ela PUKA, identifikuar nga letërnjoftimi me nr.038203046.

## **NENI 14** **KOMPETENCAT**

14.1 Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos me 1/2 e votave të ortakëve pjesmarrës për emërimin e administratorit. Vendimi për emërim është i vlefshëm nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

14.2 Afati i emëritimit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

14.3 Administratori ka këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të



- shoqërisë;
- d) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpëra asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g) të raportojë përpëra asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

#### 14.4 Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njofuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturën e aparatit te shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.

14.5 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## KREU V

### PRISHJA E SHOQËRISË

#### NENI 15

##### 15.1 Shoqëria prishet:

- a) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- b) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- c) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar
- c) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- d) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

16.2 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likujdimit. Gjate fazes së likujdimit emrit të shoqërië i shtohet pjesa “Në likujdim” që shënohet në të gjitha dokumentet që shoqëria nxjerr gjatë kësaj periudhe.

16.3 Likujduesi i emeruar nga Asambleja e Përgjithshme, kërkon ç’regjistrimin e shoqërisë pranë QKB, pas shpërndarjes së aktiveve të mbeturë të shoqërisë.

## VITI FINANCIAR

### **NENI 16**

16.1 Në përputhje me ligjin, shoqëria do të ketë një regjistër në te cilin mbahen bilancet vjetore, raporte financiare vjetore dhe çdo kërkesë tjeter ligjore.

### **NENI 17**

17.1 Viti finanziar i shoqërisë fillon në 1 Janar të çdo viti kalendatik dhe përfundon në 31 Dhjetor të po këtij viti, me përjashtim të vitit të regjistrimit, ku viti finanziar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon në 31 Dhjetor.

## **DIVIDENTËT**

### **NENI 18**

18.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe përcaktimit të destinimit të fitimit, Asambleja përcakton shumën që do të ndahet si dividente, bazuar në kuotat që zotëron çdo ortak.

## **PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE**

### **NENI 19**

19.1 Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit të themelimit dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendrën Kombëtare të Biznesit.


19.2 Shoqëria ka vulën e saj në të cilën shkruhet emri i shoqërisë sic e parashikon ligji.

19.3 Për ato që nuk janë parashikuar në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit.

Statuti është hartuar në 2(dy) kopje originale me të njejtën fuqi ligjore.

## **ORTAKU THEMELUES**

**Shoqëria “AKSENT L&BC” Shpk  
Përfaqësuar nga z. Ened Janina,  
sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve**

  
Ened Janina